



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 qershor 2011
Nr. ref.: RK120/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 124/10

Parashtruesi

Shkurte Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
A.nr. 771/2010, të datës 27 tetor 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Shkurte Krasniqi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesja e kërkesës është aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), A.no.771/2010, të 27 tetor 2010, i cili i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 1 nëntor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e kërkesës pretendon se asaj i është privuar e drejta e vazhdimit të pensionit të invaliditetit, edhe pse ajo i plotëson kushtet e domosdoshme.
4. Në këtë kuptim, parashtruesja e kërkesës pretendon se është shkelur neni 51.2 [Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Kushtetuta”).

Baza ligjore

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: “Ligji”) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Rregullorja e Punës”).

Procedura para Gjykatës

6. Më 10 dhjetor 2010, Parashtruesja e kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Gjykata”).
7. Më 14 dhjetor 2010, Kryetari me Urdhër Nr. GJR. 124/10, emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, me Urdhër Nr. KSH. 124/10 Kryetari emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalovič.
8. Më 27 janar 2011, kërkesa i është dërguar Gjykatës Supreme.
9. Më 2 mars 2011, kolegji shqyrtues e shqyrtuan raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomanduan Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Në vitin 1982, parashtruesja e kërkesës ka qenë e punësuar si motër medicinale me orar të plotë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: QKUK). Në ndërkohë parashtruesja u sëmurë nga TBC-ja në veshkë dhe iu nënshtua intervenimeve kirurgjike në vitet 1983, 1985 dhe 1989.
11. Më 22 mars 1990, Sigurimi i atëhershëm Pensional dhe Invalidor i Kosovës ia njohu parashtrueses të drejtën për punësim me orar të kufizuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore (Vendimi nr.7021296025).
12. Më 5 korrik 2007 Departamenti i Burimeve Njerëzore të QKUK-së, me kërkesë të parashtruesit të kërkesës të datës 5 mars 2007, dha pëlqimin për të ndërprerë marrëdhënien e saj të punës, duke filluar nga 1 marsi 2007, pasi që kishte pësuar sulm në zemër në orar të punës më 18 gusht 2004 (Vendimi nr.175).
13. Më 20 shtator 2007, Departamenti i Administratës së Pensioneve të Kosovës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale miratoi kërkesën e parashtrueses për pension të aftësi të kufizuar duke filluar nga 5 janari 2007 (Vendimi nr.5087134).

14. Më 6 maj 2008, parashtruesja e kërkesës iu nënshtrua operacionit në zemër.
15. Më 19 prill 2010, Komisioni për Shqyrtim Mjekësor vlerësoi se në rastin e parashtrueses nuk kishte aftësi të kufizuar permanente. Në bazë të këtij përfundimi më 26 prill 2010 Departamenti i Administratës së Tatimeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies erdhi në përfundim se parashtruesja nuk i kishte plotësuar kriteret sipas nenit 3 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar. Prandaj kërkesa e parashtrueses për pension të personave me aftësi të kufizuar u refuzua (Vendimi nr. 5087134).
16. Më 21 maj 2010, ndaj vendimit të Departamentit të Administratës të Pensioneve të Kosovës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale parashtruesja paraqiti ankesë në Komisionin për Ankesa pranë Departamentit të Administratës së Pensioneve të Kosovës.
17. Më 23 qershor 2010, Komisioni për Ankesa i Departamentit të Administratës së Pensioneve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale konstatoi se ankesa e saj ishte e pabazuar (Vendimi nr. 5087134).
18. Më 19 gusht 2010, parashtruesja e kërkesës parashtroi një ankesë pranë Gjykatës Supreme.
19. Më 27 tetor 2010, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar, për arsyetimin se dokumentet e parashtruara nga ana e parashtrueses së kërkesës nuk çonin në ndonjë përfundim apo vendim tjetër nga vendimi i organeve të shkallës më të ulët (Aktgjykimi A.nr.771/2010).
20. Më 25 nëntor 2010, pas nxjerrjes së aktgjykimit të fundit të Gjykatës Supreme, QKUK-ja lëshoi një raport mjekësor ku thuhej se bazuar në kriteret objektive dhe në ekzaminimin klinik parashtruesja e kërkesës ishte e paaftë për punë.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

21. Parashtruesja pohon se më 19 prill 2007 Komisioni për Shqyrtim Mjekësor ka bërë vlerësim të padrejtë të gjendjes së saj shëndetësore pasi që dokumentet e dorëzuara qartazi e tregojnë se për shkak të gjendjes shëndetësore të vërtetuar nga raportet mjekësore, ajo është e paaftë për punë.
22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se është shkelur neni 51 [Mbrotja shëndetësore dhe sociale] i Kushtetutës dhe se në bazë të shumë raporteve mjekësore ajo i përmbush kushtet për marrjen e pensionit të aftësisë së kufizuar sipas nenit 3 të Ligjit Nr.2003/23 për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar.
23. Për më tepër, parashtruesja vlerëson se asaj i është shkelur e drejta për asistencë mjekësore dhe sociale, e paraparë me nenin 13 [E drejta për asistencë mjekësore dhe sociale] të Kartës Evropiane Sociale në lidhje me nenin 22 [Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 51.2 [Mbrotja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, Gjykata vëren se, për të gjykuar për ankesën e parashtrueses, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Parashtruesi i kërkesës mund të ankohet vetëm nëse gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve ose të ligjit, aq sa ato të mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
26. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, Vendimi për pranueshmëri në rastin Nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli, të datës 17 June 2010 dhe, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
27. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, për shembull, Raporti i Komisionit Evr. Për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër. Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87 të miratuar më 10 korrik 1991).
28. Në këtë drejtim, vërehet se parashtruesja e kërkesës jo vetëm që nuk e ka argumentuar rastin në lidhje me shkeljen por ajo as nuk paraqitur prova relevante që tregojnë se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka qenë i padrejtë apo i njollosur nga arbitrariteti kur e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar (shih mutatis mutandis, Shub kundër. Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të dates 30 qershor 2009).
29. Për më tepër, nga dokumentet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës del se më 25 nëntor 2010 QKUK-ja lëshoi një raport të ri mjekësor ku thuhej se në bazë të ekzaminimeve të fundit klinike parashtruesja ishte e paaftë për punë. Kjo provë e re mjekësore duhet të konsiderohet si fakt i ri që do të ngrite rast të ri.
30. Siç është theksuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme Komisioni Mjekësor është ligjërisht i autorizuar për të konstatuar aftësinë ose paaftësinë e ndonjë paditësi. Prandaj Gjykata është e mendimit se Komisioni Mjekësor është organi i autorizuar të vendosë për kërkesën e parashtrueses për pranimin e paaftësisë së saj fizike bazuar në raportin e ri mjekësor të datës 25 nëntorit 2010.
31. Duket se parashtruesja nuk ka parashtruar kërkesë pranë Komisionit Mjekësor për të shqyrtuar këtë raport të ri mjekësor të datës 25 nëntor 2010 dhe se ajo nuk e ka argumentuar se si dhe përse një kërkesë e tillë e re nuk do të ishte efektive dhe, se nuk do kishte nevojë që të shfrytëzohej.
32. Në përgjithësi, rezulton që kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, më 2 mars 2011, njëzëri,

VENDOS


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani